



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government



Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense

Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Direktorat Ljudskih Resurs/Human Resources Directorate

Bazuar në Ligjin Nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.08/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes, Ligjin Nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Ligjin nr. 08/L-156 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, neni 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 i Rregullores Nr. 07/2023 për Rekrutim në FSK, , si dhe duke pasur për bazë ofertat e shteteve partnere nga Republika e Shqipërisë, nga Republika e Turqisë, Republika e Kroacisë dhe Republika e Maqedonisë Veriore, Ministria e Mbrojtjes shpall:

K O N K U R S
Për rekrutimin e kadetëve për vitin 2026/2027

Ministria e Mbrojtjes bën rekrutimin e kadetëve të cilët do të studiojnë në këto qendra universitare:

Qendra për Studime Universitare të FSK-së;

-Universiteti Amerikan në Kosovë;

25 kandidatë

Republika e Shqipërisë/Akademia Ushtarake;

- Teknologji Informative në fushën e mbrojtjes;

3 kandidatë

- Marrëdhënie Ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes;

3 kandidatë

- Shkenca Komunikimi në fushën e mbrojtjes;

2 kandidatë

- Studime në Shkenca Ushtarake;

2 kandidatë

Republika e Turqisë;

-Akademia Ushtarake Tokësore-

4 kandidatë

-Akademia Ushtarake Mjekësore-

2 kandidatë

Republika e Kroacisë- Akademia Ushtarake/Universiteti i Zagrebit;

- Lidershipi dhe Menaxhmenti Ushtarak-

2 kandidatë

Republika e Maqedonisë Veriore;

-Akademia Ushtarake-

1 kandidat

D). PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE PËRZGJEDHJES PËR STUDIME NË QENDRËN PËR STUDIME UNIVERSITARE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Kandidati që aplikon për studime në Qendrën për Studime Universitare në FSK duhet:

- Të jetë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të ketë diplomë të shkollës së mesme dhe dëshmi për testin e maturës;
- Të zotërojnë aftësitë e nevojshme shëndetësore dhe fizike për vendin e shërbimit;

- Të mos jenë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
- Të jetë i moshës 18 vjeç ditën e fillimit të javës zero për kadet;
- Të mos jetë më i vjetër se 22 vjeç në ditën e mbylljes së konkursit;
- Të kalojë me sukses procesin e verifikimit sigurisë/pastërtisë së figurës (mos kalimi me sukses i pastërtisë së figurës paraqet shkak për ndërprerjen e kontratës së shkollimit në çdo kohë);
- Kandidatët meshkuj duhet të kenë gjatësinë trupore jo më pak se 165cm, ndërsa femrat duhet të kenë gjatësinë trupore jo më pak se 160cm (kjo verifikohet gjatë fazës së testimit fizik.);
- Kandidatët të cilët bartin tatuazhe në fytyrë, qafë dhe parakrahë nga pjesa e bicepsit deri te gishtat e dorës, duke përfshirë edhe pirsingun, në rast të përzgjedhjes janë të obliguar të bëjnë heqjen e tyre paraprakisht në afatin kohor deri në fillimin e shkollimit për kadet, në të kundërtën diskualifikohen.
- Kandidatët që konkurrojnë për kadetë në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së duhet të njohin gjuhën angleze dhe të kenë notën mesatare gjatë shkollimit të mesëm jo më pak se 3.0.

Testet që aplikohen në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për studime në Qendrën për Studime Universitare në FSK:

- Ese në gjuhën angleze;
- Testi fizik;
- Testi për koeficient të inteligjencës - IQ test;
- Testi i njohurive të përgjithshme;
- Testi i gjuhës Angleze në FSK (ECL);
- Intervista;
- Testi mjekësor;
- Testi TOEFL dhe matematikë;
- Testi i karakterit (java Zero).

II) PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE PËRZGJEDHJES PËR STUDIME NË AKADEMINË E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kandidati që aplikon për studim në Akademinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë duhet:

- Të jetë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të ketë diplomë të shkollës së mesme dhe dëshmi për testin e maturës;
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme shëndetësore dhe fizike për vendin e shërbimit;
- Të mos jenë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
- Të jetë i moshës 18 vjeç ditën e fillimit të studimeve;
- Të mos jetë më i vjetër se 22 vjeç në ditën e mbylljes së konkursit;
- Të kalojë me sukses procesin e verifikimit sigurisë/pastërtisë së figurës (mos kalimi me sukses i pastërtisë së figurës paraqet shkak për ndërprerjen e kontratës së shkollimit në çdo kohë);
- Kandidatët meshkuj duhet të kenë gjatësinë trupore jo më pak se 165cm, ndërsa femrat duhet të kenë gjatësinë trupore jo më pak se 160cm (kjo verifikohet gjatë fazës së testimit fizik);

- Kandidatët të cilët bartin tatuazhe në fytyrë, qafë dhe parakrahë nga pjesa e bicepsit deri te gishtat e dorës, duke përfshirë edhe pirsingun, në rast të përzgjedhjes janë të obliguar të bëjnë heqjen e tyre paraprakisht në afatin kohor deri në fillimin e shkollimit për kadet, në të kundërtën diskualifikohen.
- Kandidatët duhet të njohin gjuhën e vendit përkatës, si dhe të kenë notën mesatare gjatë shkollimit të mesëm jo më pak se 3.0.

Testet që aplikohen në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për studime në Akademinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë:

- Testi fizik;
- Testi i inteligjencies;
- Testi i njohurive të përgjithshme;
- Intervista;
- Kontrolli mjekësor;

Dokumentacionet e nevojshme për rexhistrim në AFA të Republikës së Shqipërisë;

- *Kandidatët të cilët kalojnë me sukses procedurat e përzgjedhjes nga Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, për procedura të regjistrimit në AFA të Republikës së Shqipërisë, kërkohet dokumentacioni i e mëposhtëm:*
- Dokumentin e identifikimit (letërnjoftimi ose pasaporta);
- Fotokopje e noterizuar e diplomës së njëhsuar në QSHA me certifikatën e notave, ose një diplomë/dëftese ekuivalente për studimet jashtë vendit. Njësimi i diplomës duhet të bëhet nga kandidati para rexhistrimit në AFA.
- Deklaratën e cila plotësohet nga kandidati në prani të punonjësës së sekretarisë mësimore të AFA-së,
- Kërkesën me shkrim;
- Formularin me të dhëna personale,
- Fotografi për dokument (4x6)- 2 copë;
- Certifikatë familjare- 1 copë;
- Formular i vetëdeklarimit për gjendjen shëndetësore, i cili plotësohet pranë Sekretarisë së AFA-së, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit;
- Formular i vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes (www.mod.gov.al/baza_ligjore);
- Raport mjekësor i aftë për studime, lëshuar nga Bordi mjekësor i FSK-së, ku vërtetohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike; - ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndë narkotike, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut apo nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë;
- Dëshmi penaliteti;
- Vërtetim nga gjykata;
- Vërtetim nga prokuroria;
- Vërtetim nga përmbarimi;

Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit si dhe rexhistrimi në AFA të Republikës së Shqipërisë do të bëhet i ditur në proces.

III). PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE PËRZGJEDHJES PËR STUDIME NË AKADEMINË E USHTARAKE TOKËSORE DHE AKADEMINË USHTARAKE MJEKËSORE TË REPUBLIKËS SË TURQISË

Kandidati që aplikon për studim në Akademinë e Ushtarake Tokësore dhe Akademinë Ushtarake Mjekësore të Republikës së Turqisë duhet:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të ketë diplomë të shkollës së mesme dhe dëshmi për testin e maturës;
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme shëndetësore dhe fizike për vendin e shërbimit;
- Të mos jetë i dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
- Të jetë i moshës 18 vjeç ditën e fillimit të studimeve;
- Të mos jetë më i vjetër se 21 vjeç në ditën e mbylljes së konkursit; (kriteri i shtetit pritës);
- Të kalojë me sukses procesin e verifikimit sigurisë/pastërtisë së figurës (mos kalimi me sukses i pastërtisë së figurës paraqet shkak për ndërprerjen e kontratës së shkollimit në çdo kohë);
- Kandidatët meshkuj duhet të kenë gjatësinë trupore jo më pak se 165cm, ndërsa femrat duhet të kenë gjatësinë trupore jo më pak se 160cm (kjo verifikohet gjatë fazës së testimit fizik);
- Kandidatët të cilët bartin tatuazhe në fytyrë, qafë dhe parakrahë nga pjesa e bicepsit deri te gishtat e dorës, duke përfshirë edhe pirsingun, në rast të përzgjedhjes janë të obliguar të bëjnë heqjen e tyre paraprakisht në afatin kohor deri në fillimin e shkollimit për kadet, në të kundërtën diskualifikohen.
- Të jetë beqar/e –i/e pafejuar, i/e pamartuar (kriteri i shtetit pritës);
- Të mos kenë precedentë penalë në shtetet tjera (kriteri i shtetit pritës).
- Kandidatët duhet të kenë notën mesatare gjatë shkollimit të mesëm jo më pak se 3.0 , po ashtu shkollimi do të vijohet në gjuhën turke.

Shënim; Kandidatet e përzgjedhur do të ndjekin kursin e gjuhës turke një vit para fillimit të shkollimit në institucionet ushtarake të Republikës së Turqisë.

Testet që aplikohen në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për studim në Akademinë e Ushtarake Tokësore dhe Akademinë Ushtarake Mjekësore të Republikës së Turqisë:

- Testi fizik;
- Testi për koeficient të inteligjencës - IQ test;
- Testi i njohurive të përgjithshme;
- Testi kualifikues akademik për njohuritë në matematikë, fizikë, biologji, kimi; (pala pritëse)
- Intervista;
- Kontrolli mjekësor.

IV) PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE PËRZGJEDHJES PËR STUDIME NË AKADEMINË USHTARAKE/UNIVERSITETI I ZAGREBIT TË REPUBLIKËS SË KROACISË

Kandidati që aplikon për studim në Akademinë e Ushtarake/Universiteti i Zagrebit i Republikës së Kroacisë duhet;

- Të jetë shtetas të Republikës së Kosovës;

- Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të ketë diplomë të shkollës së mesme dhe dëshmi për testin e maturës (Kandidatët duhet të fillojnë procedurën për njohjen e kualifikimeve të shkollave të mesme të huaja në Republikën e Kroacisë dhe rekomandohet që ta bëjë këtë përpara se të mbërrijë në Republikën e Kroacisë).
- Të zotërojnë aftësitë e nevojshme shëndetësore dhe fizike për vendin e shërbimit;
- Të mos jenë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
- Të jetë i moshës 18 vjeç ditën e fillimit të studimeve;
- Të mos jetë më i vjetër se 22 vjeç në ditën e fillimit të shkollimit ushtarak(kriter i shtetit pritës);
- Të kalojë me sukses procesin e verifikimit sigurisë/pastërtisë së figurës (mos kalimi me sukses i pastërtisë së figurës paraqet shkak për ndërprerjen e kontratës së shkollimit në çdo kohë);
- Kandidatët meshkuj duhet të kenë gjatësinë trupore jo më pak se 165cm, ndërsa femrat duhet të kenë gjatësinë trupore jo më pak se 160cm (kjo verifikohet gjatë fazës së testimit fizik.);
- Kandidatët të cilët bartin tatuazhe në fytyrë, qafë dhe parakrahë nga pjesa e bicepsit deri te gishtat e dorës, duke përfshirë edhe pirsingun, në rast të përzgjedhjes janë të obliguar të bëjnë heqjen e tyre paraprakisht në afatin kohor deri në fillimin e shkollimit për kadet, në të kundërtën diskualifikohen.
- Kandidatët duhet të njohin gjuhën e vendit përkatës, si dhe të kenë notën mesatare gjatë shkollimit të mesëm jo më pak se 3.0.
- Të mos jetë nën hetime/akuza penale (pa procedura të vazhdueshme/tanishme) (kriter i shtetit pritës);
- Të ketë një dëshmi të verifikimit në lidhje me hetimet/akuzat penale (pa verdiktin përfundimtar për akuzat penale) vërtetimin nga gjykata (kriter i shtetit pritës);
- Kandidatët e përzgjedhur që nuk njohin gjuhën kroate, do të vijojnë paraprakisht kursin e gjuhës kroate, nga shtatori 2026 deri korrik 2027 në Institutin Croaticum në Kroaci. para fillimit të shkollimit në Akademinë Ushtarake të Republikës së Kroacisë.

Testet që aplikohen në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për studim në Akademinë e Ushtarake/Universiteti i Zagrebit i Republikës së Kroacisë:

- Intervista fillestare/testi me shkrim në gjuhën kroate;
- Testi fizik;
- Testi i inteligjencies;
- Testi i njohurive të përgjithshme;
- Intervista;
- Kontrolli mjekësor;

Procedurat e detyrueshme para regjistrimit të kandidatëve në Akademinë e Ushtarake/Universiteti i Zagrebit i Republikës së Kroacisë:

Kandidati sjell në intervistë (në mbështetje dhe bashkëpunim me zyrën e rekrutimit në FSK-së) :

- Certifikatën e sjelljes së mirë;
- CV-në në gjuhën kroate (formati Evropës);
- Pyetësoin e plotësuar për kontroll të sigurisë - Niveli III
- Formularin dhe certifikatën e përmbushur dhe të certifikuar për nivelin e aftësive fizike dhe psikologjike.

Pas pranimit të informacioneve në lidhje me pranimin e kandidatit nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë, kandidati është i detyruar t'i përmbushë pikat në vijim:

- Të regjistrohet si një përdorues i ri në faqen e internetit www.postani-student.hr,
- Gjatë procesit të regjistrimit, përdoruesi do të pranojë përmes mesazhit (SMS) mbiemrin e tij, fjalëkalimin, PIN dhe TAN,
- Hyrje në të dhënat personale dhe informacionet e edukimit;
- Hyrje në notat e të gjitha lëndëve që ai/ajo ka pasur në shkollën e mesme;
- Regjistrohu për programin e dëshiruar të studimit.

Regjistrimi: Kandidati i pranuar në Akademinë e Ushtarake/Universiteti i Zagrebit i Republikës së Kroacisë duhet t'i dorëzojë këto dokumente sipas afateve të udhëzuara nga Ministria e Mbrojtjes:

- Dëshmi e shtetësisë sipas të cilave kandidati aplikon (kopje të pasaportës të certifikuar nga një noter publik);
- Dëshmi e përfundimit të shkollës së mesme - kopje të certifikatave shkollore për çdo vit të shkollës së mesme me përkthim të vërtetuar në gjuhën kroate;
- Kopje e lëshuar e diplomës shkollore me përkthim të vërtetuar në gjuhën kroate.
- certifikatën e lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit të vlefshëm personal,
- Një fotografi me ngjyra 4 x 6 cm,
- CV Europass në kroatisht (<https://europa.eu/europass/hr>),
- Formularët e plotësuar dhe të vërtetuar dhe vërtetimet e nivelit të aftësive fizike dhe mendore (formularët janë bashkangjitur);
- Certifikata e kontrollit të sigurisë së kryer / kriteret e sigurisë të përmbushura,
- Dokumentet mund të sigurohen edhe si kopje të pa certifikuara brenda afateve të përcaktuara, por origjinalet ose kopjet e vërtetuara duhet të dorëzohen në momentin e pranimit.
- Dokumentacioni që nuk është i shkruar në gjuhën përkatëse dhe në alfabetin latin duhet të përkthehet në gjuhën kroate dhe të vërtetohet nga një përkthyes gjyqësor.

V). PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE PËRZGJEDHJES PËR STUDIME NË AKADEMINË E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Kandidati që aplikon për studim në Akademinë e Ushtarake të Republikës së Maqedonisë së Veriut duhet:

- Të jetë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të ketë diplomë të shkollës së mesme dhe dëshmi për testin e maturës;
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme shëndetësore dhe fizike për vendin e shërbimit;
- Të mos jetë i dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
- Të jetë i moshës 18 vjeç ditën e fillimit të studimeve;
- Të mos jetë më i vjetër se 22 vjeç në ditën e mbylljes së konkursit;
- Të kalojë me sukses procesin e verifikimit sigurisë/pastërtisë së figurës (mos kalimi me sukses i pastërtisë së figurës paraqet shkak për ndërprerjen e kontratës së shkollimit në çdo kohë);
- Kandidatët meshkuj duhet të kenë gjatësinë trupore jo më pak se 165cm, ndërsa femrat duhet të kenë gjatësinë trupore jo më pak se 160cm (kjo verifikohet gjatë fazës së testimit fizik);

- Kandidatët të cilët bartin tatuazhe në fytyrë, qafë dhe parakrahë nga pjesa e bicepsit deri te gishtat e dorës, duke përfshirë edhe pirsingun, në rast të përzgjedhjes janë të obliguar të bëjnë heqjen e tyre paraprakisht në afatin kohor deri në fillimin e shkollimit për kadet, në të kundërtën diskualifikohen.
- Kandidatët duhet të njohin gjuhën e vendit përkatës (gjuhën maqedonase) si dhe të kenë notën mesatare gjatë shkollimit të mesëm jo më pak se 3.0.
- Kandidati që zotëron njohjen e gjuhës serbo-kroate, do të këtë mundësi përvetësimi më të lehtë të gjuhës maqedonase gjatë shkollimit në Akademinë Ushtarake.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Diploma e shkollës së mesme, (diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'i nënshtrohen procesit të njohjes nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë);
- Ekstrakti i lindjes (jo më të vjetër së gjashtë (6) muaj);
- Certifikata nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetime (dokumenti të jetë i nxjerrë brenda afatit të konkursit);
- Kopje të letërnjoftimit apo pasaportës;
- Foto portret 4x4 për aplikim (elektronike);
- Dëshmi për kualifikime tjera (nëse posedon);
- Dokumenti i zotësisë së veprimit (ky dokument kërkohet pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes).

E drejta në ankesë:

- Të drejtën e ankesës e ka çdo kandidatë pas marrjes së rezultateve të çdo faze të testimit përkatës. E drejta për ankesë aplikohet për të gjitha llojet e testimit ku është përgjegjës FSK-ja dhe nuk aplikohet për llojet dhe fazat e testimit të vendosura nga akademitë e vendeve pritëse.
- Rezultatet publikohet në ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, dhe kandidatet e eliminuar kanë të drejtë ankesë brenda afatit 2 ditor. Afati i ankesës rrjedh ditën pasuese pas publikimit të rezultatit.

Kushtet tjera:

- Kandidatët që konkurrojnë nga shoqëria civile për studime në Akademitë/Institucionet ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe përzgjidhen, marrin statusin e kadetit dhe realizojnë pagën e kadetit të FSK-së deri në përfundimin e studimeve;
- Pjesëtarët e FSK-së të cilët përzgjidhen për studime në Akademitë/Institucionet ushtarake brenda dhe jashtë vendit marrin statusin e kadetit dhe realizojnë pagën e kadetit të FSK-së deri në përfundimin e studimeve.
- Kandidatët që përzgjidhen nga shoqëria civile për studime në Akademitë/Institucionet ushtarake brenda dhe jashtë vendit, në rast të dështimit të përfundimit të studimeve, i nënshtrohen kritereve sanksionuese të kontratës;
- Pjesëtarët e FSK-së të cilët përzgjidhen për studime në Akademitë/Institucionet ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe marrin statusin e kadetit, në rast të dështimit në përfundimin e studimeve, i nënshtrohen kritereve sanksionuese të kontratës duke kthyer mjetet e investuara, mirëpo i ofrohet mundësia të kalojë në gradën paraprake të shërbimit;
- Kadetët që ndjekin shkollimin në Akademitë ushtarake brenda apo jashtë vendit, janë të obliguar të shërbejnë dyfishin e kohës së shkollimit, e cila rregullohet dhe përcaktohet me kontratë;
- Dhënia e informatave të rrejshme kurdo që zbulohet, gjatë procesit të rekrutimit apo gjatë shërbimit në FSK, rezulton me largim nga FSK-ja.

VI) AFATI I KONKURRIMIT;

- Konkursi i rekrutimit për kadetë do të jetë i hapur prej **01.06.2026** deri më **15.06.2026**.

Si të aplikoni;

Aplikimi është online në adresën <https://rekrutimi.fsk-rks.org/Apply> si dhe njoftimi për shpalljen e konkursit mund të gjendet edhe në web faqen e MM-së, <https://mod.rks-gov.net> . **Kandidatët plotësojnë formularin e aplikimit online <https://rekrutimi.fsk-rks.org/Apply> dhe bashkëngjisin të gjitha dokumentet sipas këtij konkursi dhe të kërkuara nga ky formular.** Kandidatet kanë të drejtë të aplikojnë deri në ditën e fundit të përmbylljes së konkursit. Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr. tel. 038-555584 5690 si dhe 038-555584 5691 nga ora 09:00 deri 15:00.

Ministria e Mbrojtjes u shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikacione të femrave dhe meshkujve për kadetë të FSK-së, pa dallim nga përkatësia e tyre etnike.